



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2080 / Prot.
1

Tiranë, më 9.4. 2021

U D H Ë Z I M

Nr. 9, datë 9.4. 2021

PËR

ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË, NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, VITI SHKOLLOR 2020-2021
(SESIONI I PARË)

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 26 e 50, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë për vitin shkollor 2020-2021 (sesioni i parë) do të zhvillohen si më poshtë:
 - a) Lënda "Gjuhë shqipe", më 16 qershor 2021.
 - b) Lënda "Matematikë", më 21 qershor 2021.
 - c) Lënda "Gjuhë e huaj" e parë, më 25 qershor 2021.
2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën "Gjuhë amtare". Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën "Gjuhë amtare", do të zhvillohet më 11 qershor 2021.
3. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë.
4. Gjuhët e huaja të para, që do të jepen si provim i detyruar, janë: "Anglisht", "Frëngjisht", "Italisht" dhe "Gjermanisht". Testi i gjuhës së huaj të parë hartohet në përputhje me gjuhën e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

5. Nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe franceze, italiane dhe gjermane japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.
6. Çdo provim kombëtar i arsimit bazë fillon në orën 10:00 dhe zgjat 2 orë e 30 minuta.
7. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicës kombëtare greke, ndiqet procedura si vijon:
 - a) Testi, përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Fier.
 - b) Mësuesit dhe pedagogu që hartojnë testin propozohen nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Gjirokastrë-Libohovë, ZVAP Finiq-Dropull dhe ZVAP Sarandë-Konispol-Delvinë.
 - c) Grupi i punës që përgatit testin mblidhet në ZVAP Gjirokastrë-Libohovë.
 - ç) Testi tërhiqet në ZVAP Gjirokastrë-Libohovë.
 - d) Përfaqësuesit e ZVAP Finiq-Dropull dhe ZVAP Sarandë-Konispol-Delvinë e tërheqin testin në ZVAP Gjirokastrë-Libohovë, një ditë para provimit, ndërsa ata të ZVAP Gjirokastrë-Libohovë e tërheqin testin në ditën e provimit.
8. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicës kombëtare maqedonase, ndiqet procedura si vijon:
 - a) Testi, përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të DRAP-së Korçë.
 - b) Grupi i punës që përgatit testin mblidhet në DRAP Korçë.
 - c) Testi tërhiqet në DRAP Korçë.
 - ç) Përfaqësuesit e ZVAP Korçë-Pustec e tërheqin testin në ditën e provimit.
9. Nxënësit me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollat e zakonshme, i zhvillojnë provimet kombëtare, bazuar në planin edukativ individual me të cilin punojnë në përshtatje me veçoritë e tyre.
10. Drejtoria e institutit të nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, e tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QShA), një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.
11. Nxënësit mbetës në provimet kombëtare të arsimit bazë kanë të drejtë t’i japin ato në sesionin e dytë sipas procedurave të parashikuara në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë.
12. Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVAP, merr nga qendrat e vlerësimit të testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të testeve dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen

nëpërmjet DRAP-së në QShA dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

13. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Evis KUSHI

